
Ervin Budo

# Udhërrëfyesit turistikë - ne, ambasadorët e turizmit në Shqipëri

Keni imagjinuar ndonjëherë t'u tregoni miqve tuaj të huaj si ishte jetesa në një shtëpi karakteristike gjirokastrite 300-vite më parë?! Për udhërrëfyesin Ervin Budo **"sfida është ti japësh jetë këtij shpjegimi, ti bësh turistët pjesë të asaj bote 300-vjeçare…."**

Ervin Budo ushtron profesionin e udhërrëfyesit prej vitit 2000, i nxitur nga pasioni për gjuhët e huaja dhe dëshira për të udhëtuar. **"Pas 15 vite eksperiencë vendosa të investoj për veten, për tu bërë një udhërrëfyes profesionist"** - tregon entuziast Ervini.

U rregjistrua dhe ndoqi trajnimin e parë për udhërrëfyesit kombëtarë të ofruar nga Shoqata Kombëtare e Guidave Turistike

# Casting tourist guides' identity

Have you ever imagined how would you describe to your international friends the way of living in a traditional Gjirokastra house some 300 years ago?! For tourist guide Ervin Budo **"the challenge is to make them experience the world of Gjirokaster as it was 300 years ago, to feel it and see it with their own eyes".**

Ervin Budo has been working as a tourist guide since 2000, inspired by the passion for travelling and learning foreign languages. **"After 15 years of experience i decided to invest in myself and become a professional tourist guide"** - says Ervin with a light in his face.

He registered and attended the first training for national tourist guides

në Shqipëri, NATGA dhe të çertifikuar nga Federata Botërote e Udhërrëfyesve Ruristikë, WFTGA. **"Trajnimi ishte vërtet shumë i dobishëm. Mësuam se edhe detajet në dukje jo shumë të rëndësishme, si mënyra e qëndrimit, gjuha e trupit, timbri i zërit, rregullat e sigurisë, e veçojnë një udhërrëfyes profesionist nga një amator"** - tregon Ervini, një nga 17 udhërrëfyesit e çertifikuar që morën pjesë në këtë trajnim.

Udhërrëfyesit turistikë, janë një prej hallkave kryesore të zinxhirit të industrisë së turizmit në vend. Ishte viti 2014 ai, që shënoi pikën e kthesës për këtë kategori të grupuar tanimë nën ombrellën e NATGA-s. Me një vizion të ri, shoqata nisi rrugëtimin për ti kthyer identitetin e munguar guidës turistike.

Me mbështetjen e projektit Risi Albania, u hodhën hapat e parë drejt standartizimit dhë çertifikimit të udhërrëfyesve turistike, u hartuan kurrikulat e para të trajnimeve

provided by the National Association of Tourist Guides of Albania, NATGA and certified by the World Federation of Tourist Guide Associations, WFTGA. **"The training was very useful. We learned that even small details, like the way of standing, body language, voice tone and safety regulations, can clearly make a difference between a professional tourist guide and an amateur one"** explains Ervin, one of the 17 certified participants on this training.

2014 marked the turning point for this group, assembled now under the umbrella of NATGA, inspired and guided by a new vision towards casting tourists Guides' Identity in Albania.

With the support of RisiAlbania Project, first efforts focused on standardisation and certification of the tourist guides; the first trainings curricula and the training manuals for 8 different tourist guiding



dhe u pregatitën manualet e trajnimit për 8 fusha të ndryshme guidimi që sot mund të përdoren nga të gjithë ofruesit e këtyre trajnimeve. NATGA sot ofron trajnime për udhërrëfyes (a) kombëtar, (b) lokal dhe (c) me interes të veçantë. 150 udhërrëfyes turistikë janë trajnuar, çertifikuar dhe kanë ndjekur uorkshopet e ofruara nga shoqata përgjatë periudhës 2015-2016, duke e shndëruar NATGA në një aktor të rëndësishëm në industrinë e turizmit në vend.

Sfida e NATGA-s sot është ofrimi i shërbimeve cilësore si trajnime, uorkshope, aktivitete dhe rritja e anëtarësisë. Përmes portalit www.natga.al i ndërtuar me mbështetjen e RisiAlbania turistët apo operatorët turistikë mund të përzgjedhin guida të kualifikuara, të cilët i shtojnë vlerë destinacioneve në Shqipëri, nëpërmjet artit të interpretimit.

**"Ne nuk do të kishim arritur në këtë fazë zhvillimi pa mbështetjen e projektit Risi Albania, i cili pa tek ne potencialin për t'u shndërruar në factor kyç në industrinë e turizmit në vend"** - rrëfen Adrian Mitrovasili, koordinator i NATGA. Ai beson se investimi i Risi Albania po kthehet shumëfish përmes rritjes së vazhdueshme dhe të qëndrueshme të shoqatës e cila po punon sipas një plan biznesi shumë ambicioz të zhvilluar në bashkëpunim me projektin RisiAlbania.

Shoqata vlerëson se industrisë së turizmit në vend i nevojiten deri në 1500 udhërrëfyes turistike, rreth 10 herë më shumë nga sa ofron tregu sot. Kjo do të përkthehej në 1500 vende pune për të rinj si Ervini, të cilët kërkojnë përgatitje profesionale, kualifikime dhe trajnime të çertifikuara.

fields were prepared and are available for all interested training providers. Today, NATGA offers trainings for (a) national, (b) local, and (c) for special interests tourist guides. 150 tourist guides were trained, certified and attended NATGA workshops during 2015-2016, making NATGA an important player in Albania`s tourism industry.

The challenge ahead of NATGA is to offer qualitative services, like trainings, workshops, events, and increasing its membership. Through NATGA`S portal, www.natga.al, developed with RISI Albania assistance, visitors and tour operators looking for qualified tourist guides can chose from all the association members CVs published on the web page.

**"It was RISI Albania project who found in us the great potential for transforming NATGA into a key player for the Albanian tourism industry"**, says Adrian Mitrovasili, NATGA coordinator. He believes that the investment of RisiAlbania has a high return rate through continuous and sustainable enlargement of the association, which works according to a very ambitious business plan designed with Risi`s support.

The association estimates that the tourism industry in the country needs up to 1,500 tourist guides, 10 times more what the market offers today. This will result in 1,500 new jobs for young people who need professional training, qualification and certification.